



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/22
Datë: 07.09.2020 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 07.09.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për

formimin e Komisionit për hartimin e (projekt) Rregullores për perkujdesjen dhe mbrojtjen e femiut

- I. Me këtë vendim formohet Komisioni për hartimin e (projekt) Rregullores për perkujdesjen dhe mbrojtjen e femiut/në tekstin e mëtejme Komisioni/.
- II. Komisioni ka për detyrë që të hartojë (projekt) Rregulloren në harmoni me ligjet në fuqi si dhe nevojat dhe mundësitë e komunës së Junikut për zbatimin e saj.
- III. Komisionin e përbejnë 4 anetare. Dy nga radhet e kuvendit kurse dy nga radhet e ekzekutivit.

1. Perberja nga radhet e kuvendit:

1. Sindije Idrizaj; dhe
2. Florim Shala.

2. Perberja nga ana e ekzekutivit:

1. Arton Krasniqi,
2. Venera Shala,
3. Valbona Gaxherri,

IV. Pas hartimit të (projekt) Rregullores nga ana e Komisionit, (projekt) Rregullorja i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 297

<http://rks-gov.net/junik>


Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem KRASNIQI

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 297

<http://rks-gov.net/junik>